

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Mbikëqyrja e punimeve të zbatimit për objektet e parashikuara nga OST sh.a., për vitin 2023”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

71247000-1-Mbikëqyrja e punes së ndërtimit

71248000-8-Mbikëqyrja e projektit dhe dokumentacionit

VLERA E FONDIT LIMIT:

25,312,564 (njëzet e pesë milion e treqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e katër)
Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “**Operatori i Sistemit të Transmetimit**” (OST) sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 25,000,000 (njëzet e pesë milion) Leke.*

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance të fundit, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilesine e shërbimeve objekt procedure prokurimi, kerkohet qe OE ofertues te paraqese se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare per ta realizuar ate ne kohe dhe ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara. Per kete, OE ofertues duhet te kete disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me kete qellim, eshte argumentuar se vlera e xhiros te jete ne masen 25,000,000 (njëzet e pesë milion) Leke.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete realizuar gjate tri viteve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata te ngjashme ne nje vlere te pakten prej 10,000,000 (dhjetë milion) Lekë pa TVSH.*

Lidhur me kete pike:

Kur OE ka realizuar kontrata me nje ent publik, kerkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasine dhe cilesine e shërbimeve objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë afër limitit maksimal dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licensë profesionale për Mbikqyrje dhe Kolaudim të Punimeve të Zbatimit, e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme, (sipas modelit të lëshuar nga institucioni kompetent për dhënien e licencave profesionale sipas legjislacionit në fuqi) për këto kategori:*

- *NP-1 Punime gërmimi në tokë*
- *NP-2 Ndertime civile dhe industriale*
- *NP-3 Rikonstrukcion dhe mirmbajtje godinash civile e industrial, veshje fasadash*
- *NP-4 Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale*
- *NP-9 Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime*
- *NP-11 Ndertime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë*
- *NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit*
- *NS-1 Punime për prishjen e ndertimeve*
- *NS-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese*
- *NS-7 Barriera dhe mbrojtje rrugore*
- *NS-8a Ndërtim parafabrikat beton-arme*
- *NS-8b Struktura metalike*
- *NS-9 Punime strukturore speciale*
- *NS-10 Shtresa dhe mbistruktura speciale*
- *NS-12 Impiante teknologjike termike dhe të kondicionimit*
- *NS-13 Impjante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni*
- *NS-14 Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV etj.*

- *NS-18 Punime topogjeodezike*
- *NS-19 Sistemet kundra zhurmës për infrastrukturë*
- *NS-20 Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime*

Argumentimi: Kategoritë e licencës profesionale të OE-së janë në përputhje me pikën 4, të Nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, si dhe në përputhje me punimet që do të kryhen për objektet pjesë e kontratës. Në total mbikëqyrja do të zbatohet për te pakten 13 objekte të cilat kanë shumellojshmeri të ndryshme punimesh.

Duke qene se objektet të cilat do i nenshtrohen rikonstruksionit kanë punime të natyrave të ndryshme është e nevojshme që operatorët ekonomike ofertues të jene të pajisur me kategorite e mesiperme të licensave profesionale të shoqerise.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij përfshirë në licencën e shoqërisë si drejtues teknik, inxhinieret si më poshtë:

- *1 (një) Inxhinier Ndërtimi,*
- *1 (një) Inxhinier Ndërtimi Profili Strukturë,*
- *1 (një) Inxhinier Elektrik,*
- *1 (një) Inxhinier Hidroteknik,*
- *1 (një) Inxhinier Gjeolog,*
- *1 (një) Inxhinier Mekanik Teknolog,*
- *1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder*

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet të disponoje kontratë pune të vlefshme, diplomë, librezë pune dhe të vërtetuar në listpagesa, për 6 (gjashtë) muajt e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa për inxhinierët e sipërpërmendur është në përpjestim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës dhe me aftësitë zbatuese të ofertuesit. Ky kriter respekton parimin e mosdiskriminimit dhe është kërkesë e mundur të plotësohet nga cdo OE që ka në objektin e tij tregtar këtë natyrë shërbimi. Kjo kërkesë për kualifikimin e nevojshëm profesional është në përputhje me Nenin 41 “Kontrata e shërbimeve” të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) dhe nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

2.3.4 *Operatori ekonomik, si staf ndihmës duhet të ketë të punësuar për periudhën e 3(tre) muajve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, inxhinieret dhe ekspertet si më poshtë:*

- 2 (dy) Inxhinierë Ndërtimi
- 1 (një) Inxhinier Elektronik/ Telekomunikacion/IT
- 1 (një) Inxhinier Elektrik Profili Energjetikë
- 1 (një) Inxhinier Mekanik
- 1 (një) Inxhinier Mjedis
- 1 (një) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier Gjeolog/Gjeodet/Topograf
- 1 (një) Ekspert Mjedis për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis
- 2 (dy) ekspertë të pajisur me Certifikate për sigurinë dhe shëndetin në punë gjatë realizmit të punimeve, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune” dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”
- 2 (dy) ekspertë Privat Zjarrfikës në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 152/2015 datë 21.12.2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje listpagesat ku te perfshihen stafi i sipercituar, kontrata e pune si dhe deshmite e kualifikimit.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Ne lidhje me kerkesen e mesiperme qe operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar ekspertet e mesiperm eshte nje kriter i rendesishem qe lidhet ngushtesisht me natyren e objektit te prokurimit. Kjo kërkesë për kualifikimin e nevojshëm profesionale është në përputhje me pikën 4/b, të Nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), dhe nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

2.3.5 *Operatori ekonomik, si staf ndihmës duhet të ketë të punësuar për periudhën e 3(tre) muajve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, gjithashtu punonjesit më poshtë:*

- 1 (një) Auditues Energjetik i Certifikuar nga Agjencia per Eficencen e Energjise per te kryer auditime ne Instalime Industriale.
- 1 (një) Menaxher Energjie i Certifikuar nga Agjencia per Eficencen e Energjise.

- 1 (një) Ekspert te pajisur me çertifikatë "Per testimin e performances se produkteve te ndertimit", lëshuar nga ISTN-ja.

Shenim: Punonjesit e mesiperm mund te kontraktohen nga OE ofertues per realizimin e kesaj kontrate, nese nuk disponohen ne stafin e tij. Per kete qellim, duhet te disponohet kontrata noteriale mes paleve dhe certifikimet e punonjesve.

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje listpagesat ku te perfshihen stafi i sipercituar, kontrata e pune si dhe deshmite e kualifikimit.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Ne lidhje me kerkesen e mesiperme qe operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar ekspertet e mesiperm eshte nje kriter i rendesishem qe lidhet ngushtesisht me natyren e objektit te prokurimit. Kjo kërkesë për kualifikimin e nevojshëm profesionale është në përputhje me pikën 4/b, të Nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar), dhe nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik". Meqenese keto punonjes jane pjese ndihmese e stafit te ofertuesit, eshte caktuar qe mund te kontraktohen vetem per qellimin e realizimit te kesaj kontrate.

2.3.6 Operatori Ekonomik ofertues duhet te kete nje numer mesatar punonjesish te siguruar minimumi 25 (njezet e pese) per periudhen e 3 (tre) muajve te fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Per kete Operatori Ekonomik ofertues duhet te disponoje: Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi dhe Vertetimin E-SIG, per te njejten periudhe kohore.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Numri i fuqisë punëtore është vendosur në përputhje me volumet e shërbimit (te pakten 13 objekte qe do te mbikqyren), si dhe afatin e ekzekutimit të kontratës (24 muaj) dhe ky numër punonjësish është i mjaftueshem për realizimin në kohë dhe me sukses të saj, kjo kerkese eshte minimale dhe e mundur te plotesohet nga cdo OE qe ka ne natyren e vete kete kategori sherbimi. Kërkesa për personalin e nevojshëm, për zbatimin e kontratës është në përputhje me pikën 4/c, të Nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit

Publik” (i ndryshuar), si dhe nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

2.3.7 *Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikatat perkatese te vlefshme te ISO-ve, (te perkthyer ne shqip dhe te noterizuar) te leshuar nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si me poshte:*

- ✓ *Certifikatë ISO 45001: Sistemi i Menaxhimit për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë.*
- ✓ *Certifikatë ISO 50001: Sistemi i menaxhimit të Energjisë.*
- ✓ *Certifikatë SA 8000: Standarti për organizimin, zhvillimin, mirëmbajtjen dhe aplikimin e praktikave të pranueshme në vendin e punës, për sigurinë në punë, disiplina në punë, koha e punës, diskriminimin.*
- ✓ *Certifikatë ISO 9001: Sisitemet e Menaxhimit të Cilësisë.*
- ✓ *Certifikatë ISO 14001: Sisitemi i Menaxhimit të Mjedisit.*
- ✓ *Certifikatë ISO/IEC 27001: Menaxhimi i Sigurisë së Informacionit për arsye të objekteve të rëndësisë së veçantë.*
- ✓ *Certifikatë ISO/IEC 20000-1: “Teknologjia e informacionit - Menaxhimi i shërbimit”*
- ✓ *Certifikatë ISO 39001: “Sisitemet e menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor (RTS) - Kërkesat me udhëzime për përdorim”*

Argumentimi: Në lidhje me kërkesën që OE duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e standarteve, është menduar se ky është një kriter i nevojshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe në proporcion me të, me qëllim për të vertetuar cilësinë e shërbimit dhe garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas Standarteve Ndërkombëtare të objektit të kontratës. Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 30 të RRPP si dhe nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

- **Certifikata për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001:** është vendosur si kriter kualifikues për operatorët ekonomik ofertues sepse ka të bëjë me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila është me një rëndësi të vecantë për kryerjen e këtij shërbimi. OE ofertues që do të realizojë kontratën objekt procedure prokurimi AK duhet të marrë çdo masë të nevojshme për parandalimin dhe mos cenimin e veprimtarisë së saj.
- **Certifikatë për Sistemin e menaxhimit të Energjisë ISO 50001:** është e nevojshme si kriter kualifikues, pasi lidhet me natyrën e kontratës, veprimtarinë e mbikeqyrjes së punimeve, për të cilat duhet të ketë një siguri që nuk shpërdorohet energjia e nevojshme gjatë realizimit të punimeve. Me anë të këtij certifikimi, identifikohen dhe menaxhohen rreziqet që lidhen me furnizimin e ardhshëm të energjisë, mundësohet matja dhe monitorimi i përdorimit të energjisë për të identifikuar se ku të përmirësohet efikasiteti. Po ashtu do të përmirësohet performanca e përgjithshme për të ulur konsumin e energjisë, etj.
- **Certifikatë SA 8000: “Standarti për organizimin, zhvillimin, mirëmbajtjen dhe aplikimin e praktikave të pranueshme në vendin e punës, për sigurinë në punë, disiplina në punë,**

koha e punës, diskriminimin”, është e nevojshme si kriter kualifikues, pasi lidhet me natyrën e kontratës dhe garanton AK-ne, që ecuria e kontratës së punimeve ose ajo e mbikeqyrjes nuk do të pengohet apo vonohet nga mundësia e aksidenteve apo demtimit të punonjësve gjatë realizimit të saj, duke patur në konsideratë faktin se kantieret e punimeve janë të një natyre të lartë rrezikshmerie.

- **Certifikata për menaxhimin e cilësive ISO 9001:** është referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësive të kompanive të të gjithë sektoreve dhe të gjithë permasave. Ky kriter kërkohej nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.
- **Standardi i menaxhimit të cilësive së mjedisit ISO 14001:** është kërkuar nga AK pasi garanton se OE ofertues është i kujdesshëm ndaj mjedisit, duke menaxhuar ndikimin në mjedis që mund të ketë kryerja e punimeve objekt mbikeqyrjeje.
- **Certifikata e menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO 27001:** është e nevojshme pasi përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të sigurisë së informacionit, për shkak të rëndësisë së veçantë që ka AK në Republikën e Shqipërisë, posaçërisht në sistemin elektro-energjitik, gjykohej se informacioni duhet mbrojtur nga Kontraktori. Certifikimi sipas kësaj kategorie konfirmon ekzistencën dhe funksionimin e kontrolleve të OE ofertues dhe i jep siguri e nevojshme AK.
- **Certifikata për menaxhimin e sistemit të shërbimit TI ISO 20000-1:** është e nevojshme si kriter kualifikues, lidhet me natyrën e kontratës, pasi objekti i kontratës së kërkuar është për mbikëqyrjeve të punimeve për objektet e OST sh.a., punime të cilat kanë objekt veprimtarie edhe instalimet dhe konfigurimet e rrjeteve TI, që do të mbikeqyren nga ofertuesi i kësaj procedure prokurimi. Kjo kategori certifikimi garanton AK-ne, që investimi objekt kontrate do të realizohet nga ofertues që zotërojnë dhe ofrojnë kapacitete profesionale të cilat garantojnë realizimin me sukses dhe me cilësi, të specifikave të objektit të kontratës, sipas standardeve ndërkombëtare.
- **Certifikatë për sistemet e menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor (RTS) - Kërkesat me udhëzime për përdorim ISO 39001:** është standardi ndërkombëtar që ofron kuadrin për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Trafikut Rrugor (RTSMS), kjo certifikatë kërkohej nga AK me qëllim për të garantuar se OE është i certifikuar për sistemet e menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor për arsye se mbikëqyrja e punimeve të cilat do të behen në vende të ndryshme në Republikën e Shqipërisë, jo të urbanizuara dhe që do të ketë nevojë për levizjen e pajisjeve të renda teknologjike.

2.3.8 *Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë licencën me kod I.2.A. “Shërbime ekspertize për: Studimi dhe përgatitja e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri të ndërtesave të çdo lloji”.*

Argumentimi: Kjo kerkese eshte bere duke patur parasysh se kontratat e punimeve objekt mbikeqyrjeje jane te natyrave te tilla qe kalojne neper terrene te thyera dhe te pa aksesushme, zakonisht ne terrene malore me dendesi te larte pyjesh. Per te minimizuar rrezikun e mundshem te zjarreve ne keto zona, ku mund te rrezikohet natyra dhe gjithashtu edhe jeta e punonjesve apo e banoreve qe mund te jene afer, eshte menduar qe OE ofertues te jete i licencuar edhe per kete qellim.

Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 30 të RRPP si dhe nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese licence me kod III.2.A. “Për auditim mjedisor dhe ndikimin në mjedis”.

Argumentimi: Kjo kerkese eshte bere duke patur parasysh se kontratat e punimeve objekt mbikeqyrjeje jane te natyrave te tilla mbi auditimin mjedisor dhe ndikimin në mjedis me qëllim për të vertetuar cilësinë e shërbimit dhe garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas Standarteve Ndërkombëtare të objektit të kontratës.

Kjo kërkesë është në përputhje me Nenin 30 të RRPP si dhe nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

2.3.10. Ofertuesi duhet të ketë në pronësi ose me qira:

- *2 (dy) Pajisje GPS*

Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të disponoje: Faturë shitblerje ose kontratë qiraje të noterizuar (shoqëruar me dokumentat e pronesisë së qiradhënësit origjinal ose fotokopje e noterizuar) si dhe skedën teknike.

- *1(një) Pajisje Total Station*

Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të disponoje: Faturë shitblerje ose kontratë qiraje të noterizuar (shoqëruar me dokumentat e pronesisë së qiradhënësit origjinal ose fotokopje e noterizuar) si dhe skedën teknike.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afatit te ankimimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të kete garanci që ofertuesi do të realizoje shërbimin objekt prokurimi, ne perputhje me specifikimet teknike. Ky kriter eshte bazuar ne nenin 41, pika 4/ç, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.3.11. Ofertuesi duhet të ketë në pronësi ose me qira:

- 2 (dy) Automjete fuoristrade 4x4

Për automjetet kur janë në pronësi të disponohet certifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, siguracioni, certifikata e kontrollit teknik. Për automjetet me qira të disponohet kontrata noteriale e qirasë, certifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, siguracioni i automjetit, certifikata e kontrollit teknik.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatit të ankimimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Ky kriter është menduar, në mënyrë që AK të kete garanci që ofertuesi do të realizojë shërbimin objekt prokurimi, në përputhje me specifikimet teknike. Ky kriter është bazuar në nenin 41, pika 4/ç, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të propozojë Metodologjinë e mbikëqyrjes, Përfaqshen Teknike, Planin e punës, Organizimin e stafit për kryerjen e shërbimit. Gjithashtu në këtë propozim teknik, duhet të shprehet sa më qartë mënyra e organizimit si dhe elementet e rëndësishme që duhen pasur parasysh për realizimin e këtij shërbimi.

Argumentimi: Duke qenë se kjo kontratë është objekt procedure prokurimit të mbikëqyrjeve të punimeve, kontrata të palidhura akoma ose në proces realizimi, është e pamundur të përcaktohen saktë termat e referencës për secilin nga objektet që do të punohet, kjo edhe sepse një pjesë e tyre nuk janë përfunduar me lidhjen e kontratës akoma. Për këtë është e nevojshme që operatori ekonomik ofertues duhet të propozojë paraprakisht metodologjinë e mbikëqyrjes, planin e punës dhe organizimin e stafit.

2.3.13 Në funksion të plotësimit të Shtojcës 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emër, Mbiemër, Atesh, Adresë, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratoren e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posaçëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë, përfshirë ato teknike.

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i ketyre personave kerkon te dhëna te sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike jane hartuar duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per mallrat objekt procedure prokurimi, duke perlogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”.